

Zenel ANXHAKU

"YLL' I MËNGJEZIT" NË DOBI TË ÇËSHTJES KOMBËTARE

Numri i parë i së përdyjavshmes Yll' i Mëngjezit (The Morning Star) doli në Boston më 15 janar 1917. Fletorja botohej nën drejtimin e Parashqevi Qiriazit dhe Kristo Dakos.

Që në editorialin hapës së saj, "Yll' i Mëngjezit" kërkon dërgimin e adresave të studentëve shqiptarë për t'u shpërndarë falas këtë botim të ri në gjuhën shqipe.

Ndër të tjera, në këtë editorial evidentohet se arsimi duhet të konsiderohej si një mik shtëpie. Në editorial thuhet: "Pa ç'far është njeriu? Pas lirisë dhe drejtësisë vjen arsimi popullor, pa të cilin as drejtësia, as liria nuk mund të qëndrojnë përgjithnjë."

"Arsimi në shtëpi është një mik, larg shtëpisë është një dorëzim, në shkretëtirë një ngushëllim, në shoqëri një stoli.."

Pas editorialit, një ndër rubrikat pasuese më të rëndësishme ishte: "shqiptaro - fillet e shkëlqyer", ku Kristo Dako jep portretet e shumë të huajve me ndjenja të pastra për Shqipërinë dhe shqiptarët. Një ndër ta ishte dhe zoti Charls R. Crane dhe bashkëshortja e tij. Crane ishte Drejtor i Bankës Republikane në Çikago dhe Ambasador i Amerikës në Kinë, që udhëtimin e fundit në Shqipëri e kishin përfunduar në 1911.

Emrin e tij e përmend dhe Miss Durham në librin e saj "The Stuggle of Skutari", e cila do të shkruajë disa editoriale për "Yll' i Mëngjesit". Duke pasur simpati për shqiptarët, Crane dërgoi shtatë djem e shtatë vajza të zgjedhur prej Dakos të studionin në kolegjin amerikan të Stambollit me shpenzimet e tij. Kështu ai përdori të gjithë influencën e tij diplomatike për mbrojtjen e kombit shqiptar. Për këtë arsye, Dako e mbyll artikullin e tij me fjalët:

"Rroftë Zoti Crane dhe gjithë familja e tij!"

Një rubrikë tjetër interesante ishte dhe: "Kqyrje Politike". Në këtë rubrikë shpalosen të gjithë evenimentet kryesore të kohës,

veçanërisht lufta botërore dhe pasojat e vendimeve të aktorëve kryesorë të luftës në kurriz të Shqipërisë.

Një rubrikë tjetër që do kishte një vend të veçantë tek *Ylli i Mëngjezit* ishte dhe "Kujtime të Paharuara", shkruar nga Sevasti Qiriazhi - gruaja e Kristo Dakos dhe motra e Parashqevisë, botuesja kryesore e fletores.

Në këto kujtime, Sevasti Qiriazhi - Dako jep gjendjen e Korçës nën flakët e interesave të Greqisë. Autorja jep me objektivitet ngjarjet dhe faktet që çuan deri në shpalljen e Korçës Republikë Shqiptare për t'u shpëtuar barbarizmave të andartëve grekë, por dhe për t'u bërë të njohur fuqive ndërluftuese se Korça ishte pjesë e pandarë e Shqipërisë. Ajo shkruan: "Unë jam shqiptare. Ky është fakti më i rëndësishëm në jetën time, shumë më i rëndësishëm edhe se familja vetë, sepse vetëdija e këtij fakti, më zgjoi mendimet e mia të gjalla, më mësoi se ç'duhet të bëj dhe më pajisi me qëllimin e jetës s'ime.

Gjithashtu, më caktoi formën e qëllimit si në pikëpamjen gjeografike, ashtu dhe historike, më shtoi interesin kryesor dhe më rriti idealin që kur isha fëmijë dhe mendoja se si të punoja për të pasuruar popullin me dituri dhe për t'i zgjuar dëshirën për liri e pavarësi. Qëllimi i punës sime ishte të përgatisja popullin shqiptar për vetëpohim kombëtar, të shtoja ndjenjën e vëllazërisë midis muhamedanit dhe të krishterit, t'i inkurajoja me fjalë e vepra të punonin bashkë për vetë qeverimin e pavarësinë dhe t'u mësoja parimet themelore të lirisë së vërtetë. Këto ide më erdhën pak nga pak, tek ecja në shtegun me gjemba në punë e sipër për popullin tim, duke përpjekur ta ngreh, ta ndriçoj dhe ta çliroj gruan shqiptare nga zgjedha e rëndë e paditurisë dhe paragjykitimit".

Në vijim të numrit të parë, "Yll' i Mëngjezit" i lë një vend për të pasqyruar kuvendin e dytë të partisë të zonjave për paqe, duke u pozicionuar hapur kundër luftës. Ky kuvend u mbajt në kryeqytetin e Amerikës, më 8 dhjetor 1916, dhe Kristo Dako do të përqendrohet të japë deklaratën e këtij kuvendi si dhe mënyrën e organizimit të tij. Në një pjesë të kësaj deklarate thuhet: "Ne, zonjat e Shteteve të Bashkuara, të mbledhura këtu në emër të paqes, duke qenë të kënaqura për sigurimin e vendit tonë, por të helmuara për fatkeqësinë që mbulon kombet që vuajnë nga kjo luftë, po lidhemi bashkërisht për të kërkuar që lufta të pushojë

përfundimisht." Ishte ky Kongres që do të tërhiqte vëmendjen e Parashqevi dhe Sevasti Qiriazit, për të sensibilizuar dhe shoqërinë shqiptare për konfliktin botëror.

Në fund të fletores jepen reklama dhe lajmërimi të shqiptarëve, ku të bie në sy një lajmërim për nxjerrjen e librit të Sevasti Qiriazit - Dakos "Mjeshtëria për të shkruar letra". Një ndihmesë kjo për të gjithë emigrantët shqiptarë në Amerikë.

Në numrin e dytë të fletores, në datën 30 janar 1917, Kristo Dako shkruan një kod etik dhe profesional të gazetarisë që i është kushtuar çështjes kombëtare, por që qëndron aktual dhe për ditët e sotme.

"Fuqia dhe detyrat e shtypit" është titulli i këtij artikulli ku, ndër të tjera, shkruhet: "Të paktë janë njerëzit që nuk e kanë kuptuar se shtypi sot është agjenti më i fortë në shërbim të çdo çështjeje. Shtypi me të vërtetë është një fuqi e madhe, por nuk duhet harruar se është një fuqi e cila mund të sjellë dobi ose dëm. Që një gazetar mund t'i sjellë dobi çështjes që ka filluar, duhet që:

1) Të ketë një dituri të përgjithshme ose enciklopedike, por duhet të jetë specialist në gjeografinë e vendit dhe historinë e kombit.

2) Të ketë një bindje vetjake të vërtetë.

3) Të ketë një mendje të lirë dhe të hapur për çdo të vërtetë, sado e hidhur që mund të jetë.

4) Të ketë nder për veten e tij sa të mos mund blihet.

5) Të mos bëjë veprime të poshtra.

6) Të ketë guxim moral që të mos dobësohet përpara asnjë njeriu, përpara asnjë partie.

7) Të jetë i zoti të kuptojë drejtësisht dhe shpejt për t'i dhënë gazetës drejtim.

8) Të dijë të ruhet nga klikat dhe intrigat e partive kundërshtarë.

9) Të dijë të mjaftojë etjen e përgjithshme për lajme të vërteta.

10) Të zbavitë dhe të interesojë lexuesin duke dhënë informacion për të gjitha çështjet e ditës.

11) Të rrënjosë parime morale në mendjen e popullit.

12) Të luftojë ligësitë dhe padrejtësitë me fuqi dhe me qëndrim.

13) Të luftojë çdo formë grabitjeje dhe hipokritët.

14) Të përkrahë mirësinë dhe drejtësinë me atë fuqi që lufton ligësinë dhe padrejtësinë.

15) Të ketë guxim të kritikojë gabimet e miqve të tij dhe të lavdërojë veprimet e dobishme të kundërshtarëve të tij.

16) Gazetari nuk nevojitet të tregojë vetëm gjërat që janë të dëmshme, por duhet të tregojë ç'duhet bërë për të larguar rrezikun, për të sjellë një shërbim me dobi, kjo duke dhënë hollësira të plota.

17) Gazetari, duke folur për çështje publike dhe njerëzit që merren me to, nevojitet të mos mbajë anësi, as miqësi e as frikë, por të thotë gjithnjë të vërtetën duke mos e pasur mendjen se cila palë do të fitojë nga deklarata e mendimi i tij.

18) Sot politika është subjekti më interesant që pushton një gazetë; për këtë gazetari duhet t'i japë këtij subjekti vendin që meriton.

19) Gazetari duhet të jetë i paanshën në botimin e kritikave, që informacionin që ai jep ta pranojnë si kundërshtarët e tij, ashtu dhe miqtë e tij.

20) Gazetari, me lajmet e tij, nuk duhet të godasë karakterin vetjak të personave.

21) Në qoftë se shtypi bashkohet me politikanët, atëherë dhe shtypi është përkrahës i tiranisë, nga e cila populli i vetëvuan.

22) Më i madhi shërbim që gazetari mund t'i bëjë vendit të tij, është të ruajë sjelljen dhe të shfaqë gabimet e njerëzve që kanë fuqinë e shtetit në dorë. Qëllimi i politikanëve është të jenë të heshtur për të vënë në veprim planet e tyre, por, përkundrazi, qëllimi i gazetarit është t'i zbulojë dhe t'i botojë duke thënë të vërtetën.

23) Gazetari duhet të përdorë një gjuhë të thjeshtë që lexuesi mund ta kuptojë me lehtësi.

Shtypi nuk mund të mbrojë utopikisht një parti politike, dhe as nuk mund ta shpëtojë pa pasur përkrahjen e popullit. Pra, gazetari duhet të përkrahë opinionin publik, dhe këtë mund ta arrijë shumë më mirë, po të rrijë larg partive politike si një shërbëtor besnik i popullit .

Në këtë numër, përveç portretit të Xhorxh Washingtonit, filluan të botohen dhe krijime të Shekspirit, si "Hamleti".

Në kujtimet e saj, në faqet e "Kujtime të Paharuara", Sevasti

Qiriazzi kujton se ditën e pashkëve shkolla shqipe u rrethua nga ushtria e rregullt greke. Ajo shkruan: "Përse vallë kaq ushtri dhe kaq fuqi vetëm për një zonjë dhe për ca vajza të pafajshme, të cilat edhe nuk kishin ngjeruar nga hidhërimet e kësaj bote; apo se kishim në zemrat tona ndjenjat e shenjtëruara të atdhetarisë, sepse në venat tona lëvrinte gjaku i trimërisë së Skënderbeut, i cili na jepte guximin e luanëve, duke thënë do të luftojmë për lirinë e Shqipërisë, do ta tregojmë patriotizmin tonë edhe me vdekje.

S'jemi greke as bullgarka
jemi trime shqipëtarë."

Numri i tretë doli në 15 gusht 1917. Editori hapës i fletores nis me titullin "Presidenti Wilson dhe Yll i Mëngjezit", ku ndër të tjera shkruhet: "Yll i Mëngjezit duke marrë dije vendimin e presidentit për të mbrojtur të drejtat e kombeve dhe shteteve të vogla nga deklarata e bërë në senat më 22 janar i dërgoj këtë telegraf falënderimi:

Boston, mass january 30, 1917,
president Wilson, Washington, D.C.

Në fjalën tuaj që mbajtët përpara senatit të Shteteve të Bashkuara, kyçi i fjalës suaj ishte mbrojtja e shteteve të vogla nga goditjet dhe shkeljet e shteteve të fuqishme.

Si një përfaqësuese e shqiptarëve që rrojnë në Shtetet e Bashkuara, dëshiroj t'ju falenderoj për përpjekjet tuaja të kthjellta për të ndihmuar të tilla parime fisnike.

Me gjithë që Shqipëria është një nga shtetet më të vogla të Ballkanit, kombi shqiptar është një nga kombet më të vjetër të Evropës, dhe shpresoj se idealet tuaja, ashtu si u trupëzuan në fjalën tuaj, do të bëhen idealet e nomit ndërkombëtar, nom i cili duhet të themelohet përmbi parimet të gjithmonshme të drejtësisë.

Ju lutem të pranoni falënderimet e anëtarëve të kombit t' im të cilët me gjithë zemër bashkohen me idealet tuaja.

Parashqevi Qiriazzi
Editore e Yll i Mëngjezit

Pas kësaj letrë, Shtëpia e Bardhë nuk do të vononte të kthente përgjigje dhe në letër, ndër të tjera, shkruhet:

"White House Washington D.C. January 31, 1917

Miss Parashqevi Qiriaz

Editor of the Morning Star. Teksti në shqip i përkthyer nga fletorja:

“Presidentit shumë i vjen keq që nuk është mundur të dërgojë përgjigje të veçantë në telegramet dhe në letrat e shumta që ka marrë për fjalën që mbajti në senat më 22 janar, po ai dëshiron të paktën me këtë mënyrë të shfaqë ndjenjat e tij të thella të mirënjohjes dhe të kurajos që ka marrë nga përgjigjet e shumta të trupëzuara jo vetën në urimet tuaja, po edhe në shumë të tjera, për një fjalë të cilën ai e foli nga zemra me shpresë të madhe se mund të jetë për shërbim të tërë botës.”

Po në këtë numër, Sevasti Qiriazhi shkruan kujtimet për një takim të sajën me Naim Frashërin ku, ndër të tjera, ajo shkruan për nxitjen që i jepte poeti kombëtar arsimimit të shqiptarëve, për ta parë Shqipërinë sa më shpejt në vendin që i takonte.

“Cili është ai atdhetar që nuk i ka shijuar vjershat e këtij atdhetari të rrallë.

Qëllimi im nuk është të shkruaj një biografi të plotë për Naimin, por dëshiroj të shfaq përshtypjet e mija për të, kur u takova me të për herë të parë në Stamboll.

Ishte dita kur mbaroja mësimet e mija dhe do të dilja në botë për t'i bërë ballë pengimeve të cilat i kuptoja që do të ishin të shumta dhe të vështira siç na tha dhe ambasadori i Amerikës kur na dorëzoi diplomat.

Si u përshëndet me të gjithë, Naim beu më afrohet dhe më thotë:

“Motër, punë më të mirë dhe më të vyer nuk mund të bësh për Shqipërinë përveç se asaj që keni ndërmënt të bëni me vëllanë tuaj dhe me mikun tim të dashur, dhe e pushtoi tim vëlla.

Pengime dhe turbullime do të kini në këtë udhë të nisur, por si trime shqipëtarë ke për t'i kapërcyer të gjitha, dhe në qofshë besnike ke për të bërë vepra më të mëdha për mëmëdhenë

Të gjitha ato që do të vijnë nën hijen tënde i frymëzo me ideale të larta e të vërteta, që të arrijmë një qytetërim të vërtetë dhe kështu ta bëjmë edhe brezin tonë të pushtojë të gjitha ato vyrtete dashurije, vëllazërije, atdhedashurie dhe bashkimi që karakterizonin kohën e Skënderbeut.”

Pas këtij shkrimi, në Rubrikën e saj “Kujtime të Paharuara” Sevastia do të botojë dhe një portret të skicuar me laps të Miss Edit Durhamit për t'ua bërë të njohur të gjithë shqiptarëve fytyrën e kësaj mikeshe të madhe të Shqipërisë.

Nga veprat e Shekspirit, në këtë numër botohet "Romeo dhe Zhulieta", si dhe një portret i jetës së Aubrey Hebert, president i komitetit anglez "shqiptaro- fil "në Londër, duke dhënë rolin e tij për ruajtjen dhe kthimin e refugjatëve shqiptarë nga qyteti i Korçës dhe Beratit, të ikur për shkak të ushtrive greke në vitin 1914, e të strehuar përkohësisht në Vlorë.

Në fletoren e 28 shkurtit 1917, në rubrikën e përhershme "Kqyrje Politike" Kristo Dako jep lajmin e dhënë dhe nga gazetata "Korça" dhe "Adriatiku", të drejtuara përkatësisht nga Dhori Kotti e Arqimidhi Vangjeli, se në datën 11 dimëror 1916 është nënshkruar një marrëveshje midis atdhetarëve shqiptarë të udhëhequr nga Sali Butka, Themistokli Gërmenji e dr. Haki Mborja dhe pala tjetër nga komandanti i ushtrisë franceze në Korçë, Descoin, për vetëqeverimin e Korçës prej shqiptarëve si pjesë e pandarë e shtetit shqiptar.

Ndër të tjera *Yll'i Mëngjezit* boton dhe një prononcim të Themistokli Gërmenjit dhënë për gazetata e lartpërmendura, ku, midis të tjerave, thuhet: "Dy javë më parë isha në Korçë ku kisha vajtur fshehur, ndenja tre ditë dhe u mora vesh me degën e komitetit. Një gjë duhet të dini se në Korçë nuk ka më korçarë me mendje të ndryshkur, edhe ata më të mëdhenjtë grekomanë kuptuan se i vetmi shpëtim është të krijohet shteti shqiptar."

Në rubrikën *Njoftime*, që botohej gjithmonë në fund të fletores, të bie në sy një njoftim i Zonjës Sevasti Qiriazzi - Dako, e cila në datën 18 të muajit që botohej fletorja, ndodhej në Taunton Mass në një konferencë përpara shumë shqiptarëve. Në fjalën e saj në këtë konferencë ajo kishte thënë se: "Intrigat e huaja shkaktuan shkatërrimin e Shqipërisë" dhe, duke mbaruar, u bëri shqiptarëve një thirrje të nxehtë duke i këshilluar të përfitojnë nga parimet e larta të kombit amerikan që të mundnin t'i shërbenin Shqipërisë më mirë kur ajo t'ua kishte nevojën.

Në numrin e pestë, në 15 mars 1917, me interes për t'u përmendur është botimi i një dokumenti drejtuar administratës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku vulat e dërgimit nga Korça mbajnë mbishkrimet Korçë - Shqipëri, 2 janar 1917.

Kjo letër ishte dërguar në redaksi prej Zotit Rafail Dhimitri që vërteton se Franca e kishte pranuar faktin se Korça është Shqipëri.

Në numrin e datës 2 prill 1917 të tërheq vëmendjen" Editoriali" shkruar nga Kristo Dako me titull "Pavarësia e Shqipërisë është një nevojë për paqen botërore."

Me elokuencën e tij të mendimit, por dhe me fakte dhe harta të botuara, Dako e mbron tezën e tij deri në fund duke dhënë konkluzione të qarta.

Sevasti Qiriazhi shkruan një shkrim për Petro Nini Luarasin me titull "Shtylla e Zjarrtë e Kolonjës" ku autorja shpjegon intrigat që bënin grekët kundër arsimit në gjuhën shqipe. Në fund të shkrimit shkruhet: "Fort mirë e kishte kuptuar dhespoti i Kosturit se ç'njeri ishte Petro Nini Luarasi, prandaj e gjurmoi, e mallkoi dhe e ndoqi gjer në vdekje, duke dëshëruar të ndalojë një orë e më parë punën e tij e cila ishte e rrezikshme për Greqinë, po Petro qëndroi shtyllë e pa tundur.

Këndoni librin e Petro Ninit "Mallkimi i Gjuhës Shqipe" dhe do të shihni intrigat greke. Nuk mund të bashkohem tërësisht me mendimin e filozofit Seneka, i cili thotë: "Më e fishtëja që mund të shohë Perëndija është kur sheh të mirin të vuaj dhe të mundohet pa faj".

Unë, nga ato që kam parë gjer më sot, mund të them se: "Atdhetari i vërtetë, kur ndiqet, kur burgoset për çështjen kombëtare, ndjen një kënaqësi e gëzim të madh i cili ia shton fuqinë dhe i lartëson dinjitetin se sa kur përpiqet të ç'nderojë dhe të prishë mëmëdhenë".

Në vargun e tregimeve Shekspiriane, në këtë numër botohet tregimi "Dy zotërinj nga Verona".

Kurse në numrin e datës 30 prill 1917 hapet konkursi i Zotit Lazar Doka për të bërë pajtimtarë për "Yllin e Mëngjezit", ku shkruhet: "Këto ditë, Zoti Lazar Doka i dërgoi "Yllit të Mëngjezit" një pendë të florinjte, me porosi t'i jepet atij Shqipëtarë që do të bëjë më shumë pajtimtarë për këtë të përkohshme. Të gjithë kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë konkurs i cili hapet më 15 të prillit dhe do të mbyllet më 20 qershor, nr i 12 që do të dalë më 30 qershor, do të botojë emrin e kampionit dhe numrin e pajtimtarëve që arriti t'i bindte për pasien në bibliotekat e tyre këtë fletore të vyer. "Yll i Mëngjezit" këshillon shqiptarët të marrin pjesë në këtë konkurs pa përtrim. Kujtimi që mund të marrin është fort i bukur dhe çmimi i tij nuk është i pakët."

Në numrin e datës 15 maj 1917 botohet një shkrim i gjatë i Kristo Dakos për Isa Boletinin, duke dhënë dhe një pikturë të portretit të luftëtarit kosovar. Në shkrim jepet dhe një pjesë e një interviste që Isa Boletini i kishte dhënë një gazetari amerikan kur ishte në Londër. Kështu korrespondenti i Christian Monitor që botohet në Boston, midis të tjerave, shkruan për Luanin e Shqipërisë: "Isa Boletini, i cili mund të nxjerë 10 mijë luftëtarë, është një kryetar tipik i veshur me rroba kombëtare. Vendimet e Konferencës së Londrës për Isa Boletinin janë krejt të padrejta, me qenë se gjysma e tokës së Shqipërisë dhe gjysma e kombit iu dhanë armiqëve.

"Për besa-besën e Shqiptarit iu thom se unë kurrë nuk do të rij në prehtë sa kohë që vëllezërit e mi do të jenë nën zgjedhën e armiqëve."

*"Bini bre djem iu qofsha falë,
Thret bajraktari çuna bini,
Qitni prej milli atë pall,
Bini armikut barbar,
Një të gjallë ju mos e lini."*

Kristo Dako vazhdon: "Disa thonë se Isa Boletini e vranë, të tjerë thonë se Isa Boletini mori malet në të hyrë të malësisë së Shkodrës. Koha do të tregojë se cila është e vërtetë. Në qoftë se lajmi për vrasjen e tij vërtetohet, do të jetë një lajm i zi për tërë kombin Shqiptar, në qoftë se Isa Boletini rron, jemi të sigurtë se Luani i Shqipërisë përsëri do t'i shërbejë atdheut me trimërinë e tij të famshme dhe me besnikërinë e patundur", - e përfundon artikullin e tij Dako. Për fat të keq, ishin të vërteta fjalët e vrasjes së Isa Boletinit në vitin 1916.

Po në këtë numër *Yll i Mëngjezit* boton dhe vjershën e Vaso Pashës autorit të: "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët" me titull : "Pashko Vasa = Pasha vajton Shqipërinë". Megjithëse kjo vjershë është botuar dhe në numrin tetë të fletores, u botua përsëri, sepse në bibliotekë u gjet një variant më i zgjeruar se vjersha e botuar në numrin e mëparshëm të 30 prillit 1917.

Në numrin e datës 15 qershor 1917, që është dhe numri që mbyll përmbledhjen e parë të tri koleksioneve të *Yll i Mëngjezit*, ndër artikujt më interesantë të botuar është dhe letra e Miss Edit Durham për shqiptarët e Amerikës. Në këtë letër Mikja e madhe e shqiptarëve shkruan: "Dua t' u heq vëmëndjen patriotëve shqiptarë

se një nga kundërshtimet që kanë të huajt për një Shqipëri të lirë është se shqiptarët janë të përçarë dhe zihen midis tyre sa, megjithëse të gjithë e dëshirojnë lirinë e Shqipërisë, nuk e shohin dot se si mund të realizohet dhe në qoftë se realizohet, si mund të përmbahet. Ajo që duhet të bëjnë, është të punojnë të gjithë për njerëzimin, dhe jo për parti të veçanta priftërinjsh dhe për besimet e tyre. Një komb si një njeri i veçantë lipset të ritet vetë si një trup i vetëm. Fati i Shqipërisë qëndron në duart e shqiptarëve. Në qoftë se shqiptarët do t'i lënë mënjane mendimet e tyre të pa themelta dhe dëshpëruese për hir të lirisë së kombit, besoj se Shqipëria do të ketë një të ardhme të madhe. Po, në qoftë se kundërshtimi midis veriut dhe jugut dhe mërziçja midis feve, atëherë nuk shoh përveç se ndarjen e Shqipërisë, gjë për të cilën do të më vinte shumë keq. Unë po përpiqem të bëj atë që mund, për t'i shërbyer çështjes shqiptare, por është shumë e vështirë t'u përgjigjem të gjitha pyetjeve, në qoftë se shqiptarët vetë të mos kenë një politikë të përbashkët. U lutem bëjani të ditur këto shqiptarëve të Amerikës. Londër 20 Maj 1917."

Fjalët e Mikes së shqiptarëve janë një thirrje dhe për ditët e sotme për të arritur më të mirën në interes të vendit tonë.

Në numrin e 31 korrikut 1917 jepet një shkrim shumë i dhimbshëm që tregon për trafikimin e fëmijëve me titull: "Zonja Dako përpriqet të shpëtojë Beharen nga thonjtë e grekut". Në artikull sqarohet ngjarja kur një muaj më parë mbërrin në Worcester Antonios Pantzopoulos, i cili tre vjet më parë kishte marrë pjesë aktive në sulmet e ushtrisë greke kundër Shqipërisë. Kur ishte në Opar nën uniformën e ushtrisë Pantzopoulos, rrëmben vajzën të quajtur Behare të Sheme Myrtos, kur vajza ishte vetëm nëntë vjeç. Greku, kur mbërrin në Amerikë, e deklaron vajzën si bijën e tij. Pas pak kohësh, i kushëriri i vajzës, Adem Myslym Bute, merr vesh për vendndodhjen e të afërmes dhe nis për Boston për t'u këshilluar se ç'mund të bëjë për të rikthyer të kushërirën tek i ati. Së bashku dhe me disa shqiptarë të tjerë, nisen për të takuar Sevasti Qiriazin për t'i ndihmuar. Zonja Dako nis për Worcester për të ndihmuar miqtë, duke bërë që në të njëjtën ditë ta vërë vajzën nën kujdestarinë e shtetit deri sa të vinin prindërit e Behares. Por kthimi nuk ishte dhe aq i lehtë, pasi vajza deklaroi përpara gjykatëses se dëshironte të rinte me grekun dhe të mos

shkonte tek i kushëriri. Nga ky shkak, gjykatësja nuk mund ta merrte vendimin përpara se të dëgjonte dhe prindërit e vajzës. Në mes të korrikut, vajza u mor nga Sevasti Qiriasi, pasi Antonios Pantzopoulos u bind ta lërë vajzën, pasi mori 500 dollarë ndihma për këtë çështje nga Shqiptarët e Amerikës. Dhe në numrin pasardhës për këtë çështje jepen emrat e të gjithë emigrantëve shqiptarë që dhanë kontributin e tyre monetar, që një vajzë shqiptare të kthehej në duart e prindërve të saj.

Po në të njëjtin numër, jepen dhe shpenzimet e bëra me ndihmat e kolonive shqiptare për të bërë udhëtimet e nevojshme, pagesat për avokatin e çështjes dhe për vendosjen e një fondi për Beharen në Amerikë. Në vjeshtë, kur hapet shkolla, Beharja, me dëshirën e saj dhe të kushëririt, do të niste shkollën.

Po në të njëjtin numër, *Yll`i Mëngjezit* boton alfabetin e gjuhës shqipe së bashku me abctë e gjuhëve frënge, greke dhe turke, duke shpresuar se kjo renditje e përbashkët do të ishte një ndihmë shumë e madhe për të gjithë ata bashkatdhetarë që, fatkeqësisht, nuk kishin mësuar ende të shkruanin gjuhën e nënës, por që ishin të detyruar të mësonin gjuhën e vendeve të tjera në emigrim. Dhe në këtë numër vazhdon të publikohet dhe praktika për mësimin e gjuhës angleze në ndihmë të emigrantëve shqiptarë në Shtetet e Bashkuara.

Në numrin e datës 31 gusht 1917 botohet një kërkesë e Qeverisë Shqiptare të Korçës për të përdorur shkollën e Zonjës Dako, por veçanërisht librat shkollorë të botuar prej familjes Dako si dhe mjete mësimore të ndodhura në shkollë për nevoja mësimore. Kjo familje patriote nuk do të nguronte ta jepte këtë leje duke shkruar dhe në numrin e *Yll`i Mëngjezit* për këtë kërkesë, duke e cilësuar si një themel i mirë i vendosur nga autoritetet e Korçës.

Në numrin e 31 tetorit 1917, *Yll`i Mëngjezit* boton një editorial të shkruar nga shkëlqesia e tij Ismail Qemali, me titull: "Shqipëria dhe Shqiptarët" ku plaku i urtë tregon historinë e popullit shqiptar të etur për lirinë e tij si të gjitha vendet e tjera që e kishin fituar atë.